



PROCESVERBAL

Mbledhja e **Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)** - Rahovec, e mbajtur më **30.09.2025**, me fillim në orën **15:00** në sallën kuvendit komunal, Rahovec. Mbledhjen e kryesoi si zakonisht kryetari i komunës **z. Smajl Latifi**. Për mbajtjen e mbledhjes kuorumi ekziston. Në fillim të mbledhjes, të pranishëm ishin 20 anëtarë.

Kryetari: Përshëndetje për anëtarët e KKSBB-së, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, kapitenin Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, të shoqërisë civile, të komuniteteve pakicë, përfaqësuesit e FSK-së, përfaqësuesit e OSBE-së, LMT-s dhe zyrtarët komunalë. Është mbledhja e **pestë** e rregullt për vitin 2025. Me kërkesë të komandantit të policisë, në këtë mbledhje i kemi ftuar edhe drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Rahovecit, në mënyrë që të diskutojmë rreth temave të aspektit të sigurisë në shkolla. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,
 - Siguria në trafik,
 - Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje;
3. Organizimi i fushatave vetëdijesuse përmes aktiviteteve rekreative-kulturore, për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndërfaqësor;
4. Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe të trotuareve për sezonin e dimrit;
5. Mbrojtja e ambientit në komunën e Rahovecit;
6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
7. Të ndryshme.

Kryetari: A ka dikush ndonjë koment për këtë rend dite? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... A ka votë kundër?... Konstatoj që mund të vazhdojmë me këtë rend dite.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryetari: A ka dikush dikush ndonjë koment rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, kush është “për”?... A ka votë kundër?... Vazhdojmë!

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit:

Kryetari: Pika e dytë e rendit të ditës i ka edhe nënpikat që po i shihni. Unë po shpresoj që ne jemi dakord që gjendja e sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit vazhdon të jetë e qetë, stabile dhe pa ndonjë ndryshim thelbësor nga mbledhja e kaluar dhe nuk kemi ndonjë situatë që e ka cenuar këtë gjendje të qëndrueshme. Vazhdojmë të kontribuojmë bashkërisht në sigurinë e përgjithshme në komunën e Rahovecit.

Fazli Morina: I nderuar kryetar! Përshëndetje për anëtarët e KKSB-së, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Si zakonisht do të raportoj në pika të shkurta rreth situatës së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit, me statistika si në vijim: Gjatë këtij muaji, janë realizuar dhe vazhdojnë të implementohen 7 plane operative, 7 urdhëresa operative dhe 3 projekte. Kanë ndodhur 54 vepra penale, 2 incidente jopenale, 10 raste vjedhje, 3 raste me para falco, 7 raste të kanosjes, 2 raste hetim i vdekjes, 2 raste të substancave narkotike, 6 raste lëndim i lehtë trupor dhe 5 raste të dhunës në familje. Gjatë kësaj periudhe janë arrestuar 28 persona - prej tyre 18 persona në mbajtje 48 orë. Sa i përket sigurisë në komunikacion, janë shqiptuar në total 919 gjoba. Prej tyre, 568 gjoba për tejkalim të shpejtësisë, janë dhënë 25 gjoba në komunikacion për vozitje pa patent shofer, 86 gjoba janë shqiptuar për parking joadekuat, 21 gjoba për përdorim të telefonit gjatë vozitjes dhe 3 gjoba për prishje të rendit dhe qetësisë publike. Në shkollat e komunës së Rahovecit, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 33 pika kontrolli. Paraprakisht ka ndodhur një rast i kanosjes në shkollën e Kramovikut. Gjatë kësaj periudhe është mbajtur edhe festivali i vjeljes së rrushit “Hardhfest” më 5,6 dhe 7 shtator dhe ka kaluar në suaza normale të rendit dhe qetësisë publike, gjithnjë në koordinim të plotë me shërbimet emergjente mjekësore dhe zjarrfikësit. Duke pasur parasysh numrin e madh të pjesëmarrësve, rreth 60.000 persona, mund të vlerësojmë që Hardhfest është zhvilluar si një ngjarje e sigurt, e qetë dhe paharrueshme për të gjithë. Plani operativ më me rëndësi gjatë kësaj periudhe është vizita e presidentes të Republikës së Kosovës, më datë 09.09.2025, në Hardhfest, përkatësisht në ambientet e podrumit të verarisë “Stone Castle”. Plani i fundit është plani operativ “Zgjedhjet Lokale”. Është duke u zhvilluar fushata elektorale për zgjedhjet lokale të 12 tetorit 2025. E kemi hartuar një plan operativ, i cili përmban detyra konkrete për njësitë policore në monitorimin e fushës elektorale, me qëllim të ofrimit të sigurisë, ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike. Për momentin, fushata është duke shkuar mirë dhe pa ndonjë incident. Për drejtorët e shkollave e kam një plan të veçantë. Është hartuar plani i veprimt, ku përfshihen të gjitha veprimet e planifikuara, të dhënat e personelit policor të angazhuar, institucionet që do të bashkëpunojnë me ne, dinamika e aktiviteteve dhe përgjegjësitë. Veprimet e përfshira në këtë plan janë: vizitat në të gjitha shkollat, takimet me drejtuesit e shkollave, organizimi i takimeve në nivel stacionesh policore në mes drejtorëve të shkollave, drejtorit rajonal të policisë, drejtorit të arsimit dhe KKSB-ja. Si pikë të fundit e kam një pyetje: Është fjala për blerjen e uniformave për nxënësit. I kemi pasur disa ankesa nga prindërit. Gjatë marrjes së vendimit për blerjen e uniformave për nxënës, a diskutohet këshilli i prindërve për këtë çështje, si dhe të njëjtit a njoftohen për blerjen e uniformave?!

Shaip Shala: Përshëndetje kryetar dhe kryesues! Përshëndetje për komandanti, drejtorët e shkollave, OSBE-në, LMT-në e Austrisë. Singerisht më vjen mirë për uljen e rasteve të dhunës në familje në komunën e Rahovecit, me vetëm 5 raste. Nga 14 janari 2019, dhuna familjare është vepër penale, sipas nenit 148 të kodit penal të Kosovës. Jemi dëshmitarë të shumë rasteve që as neni e as kodi penal nuk është zbatuar, qoftë në raste të dhunës familjare, qoftë të veprave penale, ku vepra penale po trajtohet si kundërvajtje. Për këtë shkak edhe lirimi i atyre që ushtrojnë dhunë apo edhe vepra penale, kanë ngritur vetëvrasje dhe raste të tjera të “zeza”. Kur është fjala për dhunën familjare, unë i di disa raste (në biseda me gjykatësit), kur thotë: “Çfarë t’i bëj Shaip, gruaja ka hongër dajak, por po vjen e po qanë, duke thënë që mos ma burgosni burrin”. Është rasti tjetër kur burgu e ka kryer efektin e vet, është dënuar njëri 4 muaj burg dhe tanimë zëri nuk i dëgjohet. Secila vepër penale dënohet me burg mbi 6 muaj dhe duhet që sistemi i drejtësisë ashtu siç duhet, që veprat penale mos të trajtohen si kundërvajtje. Një pyetje tjetër komandant: Prej këtyre 5 rasteve, a janë raste të recidivistëve të dhunës apo është rasti i parë?

Kryetari: Të përpiqemi të jemi konkret, sepse ne jemi KKSB dhe çështjet e prokurorisë dhe të gjykatës nuk kanë vend për diskutime në këtë sallë. Jemi pushtete të ndara dhe të gjitha veprat penale, si dhe kundërvajtjet janë të parapara me ligj.

Erseka Cana: Përshëndetje për të gjithë në sallë! Një përgjigje të shkurtër për komandantin: Këshilli i prindërve është në dijeni dhe është i përfshirë në çështjet në lidhje me aktivitetet e zhvillimit nëpër shkolla. Gjithashtu, të gjithë prindërit kanë qenë të informuar me kohë, si dhe kanë qenë të ftuar në mbledhje për të diskutuar rreth uniformeve të nxënësve. Në këtë proces kanë qenë të angazhuar edhe kryetarët e KDSH-së, të cilët kanë marrë pjesë dhe e kanë dhënë kontributin e tyre në vendimin e marrë. Shumica e prindërve kanë qenë dakord që nxënësit të pajisen me uniforma, mirëpo një pjesë e vogël e paskan marrë një tjetër kahje në mungesë të informimit. Ju përkujtoj që këshilli i prindërve është në dijeni dhe nuk ka bërë asgjë pa pëlqimin e prindërve.

Kryetari: Ju përkujtoj gjithashtu që, kryetari i komunës nuk ka lidhje me uniforma. Besoj që e kuptojmë ngarkesën dhe fazën ku jemi. E falënderoj drejtorin e shkollës “Isa Boletini” për sqarimin e tij.

Beatrisa Pista Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë e përfaqësoj shkollën “Bekim Sylka”. Së pari, faleminderit për raportin e policisë, i cili ishte mjaft i qartë. Mua, si banore dhe si drejtuese e një shkolle më bënë përshtypje kundërvajtjet që janë pa patent shofer. Lajm i mirë është që në çdo lagje të jetë nga një polic. Ju rekomandoj që të vazhdoni me ligjërata në shkolla, sepse kanë qenë shumë frytdhënëse. E drejtoj shkollën që nga viti 2014 dhe pikërisht te uniformimi i nxënësve, disa prindër ose një grup i caktuar nuk dëshirojnë ta kuptojnë që uniformimi nuk është kompetencë e kryetar, as e DKA-së, por as e drejtorit të shkollës, në plotni është kompetencë e këshillit drejtues të prindërve. Jo që dua t’i përkrah këtu kolegët e mi, por me të vërtetë drejtori nuk ka lidhje me uniformë të nxënësve.

Sakip Kryeziu: Përshëndetje kryetar! Përreth shkollës tonë, nëse ekziston mundësia të jenë disa pengesa, sepse topat e betonit që kanë qenë tanimë janë deformuar. Do të ishte mirë, sepse siguria është më e madhe se krejt.

Fazli Morina: Po filloj me Shaipin atje! Faleminderit për komentin Shaip! Të garantoj që, te rastet e dhunës në familje nuk ka rast që ka kaluar në kundërvajtje, asnjë. Të gjitha rastet hetohen nga hetuesit profesionalë, duke mos i përjashtuar edhe institucionet e tjera, siç është QPS-ja, prokuroria, qendrat strehimore etj... Rëndësi të veçantë ka që numri i rasteve në familje nuk po ngritet dhe me rëndësi të madhe është minimizimi. Për ta pasur më të qartë pjesë e kundërvajtjes dhe veprës penale, po kaloj pak në shaka, por provo me ti me gruan, jepja ndonjë shuplakë, tutje ta shohim se si do të trajtohesh ti, ose të tjerët. Ka raste redediviste që janë, nuk mund të të jap shifrat të sakta. Besoj që je i kënaqur me përgjigjen. Kryetare Erseka, faleminderit për përgjigjen! Nuk e thash me qëllim, por kemi pasur ankesa dhe është dashur ta parashtroj si pyetje. Drejtoreshë Beatrisa, faleminderit për fjalë të mira. Të gjitha ato plane që janë hartuar për zonën tonë të përgjegjësisë, të gjitha duhet të implementohen në përpikëri, brenda mundësive ekzistuese. Drejtor Sakip, faleminderit për atë shqetësim me vend dhe është shumë e vërtetë që “topat” në atë hapësirë janë dëmtuar. Besoj që drejtoria përkatëse do ta eliminojë këtë problem.

Kryetari: E falënderoj komandantin e stacionit policor, kapitenin Fazli Morina, për raportin e paraqitur para KKSB-së, rrjedhimisht edhe për pjesën e raportit që ka të bëjë me sigurinë në shkolla. E falënderojmë policinë e Kosovës për sukseset e tyre, që Hardhfesti ishte pa asnjë incident. Falënderoj policinë për plot veprimet të marrura, që qetësia publike të jetë në nivele të kënaqshme për komunën tonë. E inkurajojmë policinë që përsëri të vazhdojë me ligjëratat e tyre nëpër shkolla, që kanë të bëjnë me sigurinë në shkolla, sepse është me rëndësi të madhe. Sa i përket dhunës, përveç që diskutohet në KKSB, ne gjithashtu kemi një mekanizëm komunal kundër dhunës në familje, në baza gjinore dhe dhunës ndaj gruas – ku janë të përfshirë: Policia, QPS, QKMF, gjykata, prokuroria, “Shtëpia e Sigurt” etj... Tutje, të gjitha shkollat e komunës së Rahovecit do të furnizohen me kohë me lëndë djegëse. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin, posaçërisht komandantin policor, z. Fazli Morina.

3. Organizimi i fushatave vetëdijesuse përmes aktiviteteve rekreative-kulturore, për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndërjetar:

Kryetari: Ju e dini që, në komunën tonë kemi situata edhe nga pikëpamja e marrëdhënieve ndëretnike. Është situatë e qëndrueshme, pavarësisht që këtu-aty ka ndonjë tendencë për ta shpërfaqur keq komunën tonë, ose shoqërinë tonë. Fakti që policia është e informuar dhe ne kemi të integruar mjaft qytetarë të pakicave është garancë e qëndrueshmërisë, madje ka edhe aktivitete që e shpërfaqim mozaikun e respektit dhe trajtimit adekuat. Pra, nuk kemi situata shqetësuese sa i përket kësaj pike të rendit të ditës.

4. Informatë nga Drejtoria për Shërbimeve Publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe të trotuareve për sezonin e dimrit:

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryetar! Përshëndetje për të gjithë, si dhe për drejtorët dhe drejtoreshat e shkollave. Komuna e Rahovecit ka kontratë për mirëmbajtjen e dy sezoneve. Sezona dimërore fillon prej muajit nëntor dhe përfundon në mars 2026. Janë siguruar të gjitha kushtet teknike për mirëmbajtjen e rrugëve. Për mirëmbajtje i kemi dy operatorë ekonomikë.

5. Mbrojtja e ambientit në komunën e Rahovecit:

Kryetari: Drejtoresha Norë nuk është mirë me shëndet dhe sot mungon.

Përparim Krasniqi: Komuna e Rahovecit prin në nivel nacional sa i përket mjedisit. Ne i kemi 11 deponi të evidentuara nga ministria e mjedisit në komunën tonë. Një problem serioz e kemi në pronat private, sepse operatorët nuk marrin leje nga Drejtoria e Urbanizmit për hedhjen e mbeturinave inerte në prona private.

Kryetari: Një sqarim, ka deponi ilegale në prona private që vetë pronarët privatë kanë dëshirë që t'i mbushin për nivelizim.


6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore:

Kryetari: Ka vizita sistematike nga inspektorët në markete, në furra të bukës, në mishtore dhe në çdo lloj veprimtarie që zhvillohet. Ka shumë veprime të cilat sigurisht që janë të pamjaftueshme, sepse duhet të veprohet më shumë. Fatkeqësisht, jemi të kufizuar në kompetenca dhe numri i inspektorëve në komunën tonë lë për t'u dëshiruar. Sidoqoftë, unë ju ftoj të bashkëpunojmë në mbrojtje të ambientit dhe në mbrojtje të shëndetit.

7. Të ndryshme:

Kryetari: Nëse dikush ka diçka për fund?... Nëse jo, atëherë ju falënderoj të gjithëve për kontributin, posaçërisht drejtorëve të shkollave për pjesëmarrje në mbledhjen e sotit.

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi

Kryetari i Komunës


Smajl Latifi